



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:225242
Datë: 24.04.2024
Numri i dokumentit: 05613232

PAKR.nr.158/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për të Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Xhevdet Abazi, kryetar i kolegjit, Hashim Çollaku dhe Kadrije Goga Lubishtani, anëtar, me bashkëpunëtoren profesionale Ardianë Morina, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit F.R., nga Mitrovica, për shkak të veprave penale, përdorimi i pa autorizuar i pasurisë, nga neni 420 lidhur me nenin 77 të KPK, duke vendosur sipas ankesave, të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, dhe mbrojtësit së të akuzuarit F.R., av. Shyqri Sylja, të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.43/2023, të dt.27.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt.12.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.Me aprovimin e ankesës së mbrojtësit së të akuzuarit F.R., av.Shyqri Sylja, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.43/2023, të dt.27.12.2023, përkitazi me vendimin për dënimin me burgim, ashtu që kolegji penal i Gjykatës së Apelit, të akuzuarit F.R., për shkak të veprës penale përdorimi i pa autorizuar i pasurisë, nga neni 420 lidhur me nenin 77 të KPK, i shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muajve.

II.Refuzohet si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.43/2023, të dt.27.12.2023:

I.

- është shpallur fajtor i akuzuari F.R., për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 420 lidhur me nenin 77 të KPK, dhe i ka shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muajve, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditëve, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Është obliguar i akuzuari që të paguaj shpenzimet e procedurës penale, sado që të jenë ato sipas llogarisë së bërë në arkë të gjykatës, paushallin gjyqësor në shumën prej 100 Euro, si dhe në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguajnë shumën prej nga 50Euro, në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kërkesë pasurore juridike, nuk ka pasur.

II.

Në kuptim të nenit 363 par.1 nën par.1.3 i akuzuari F.R., është liruar nga akuza për shkak të veprës penale përdorimi i pa autorizuar i pasurisë, nga neni 420 lidhur me nenin 77 të KPK, pasi që nuk është provuar se i njëjti ka kryer këtë vepër penale.

Shpenzimet e procedurës penale, për këtë pikë të aktgjykimit kanë ra në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Kërkesë pasurore juridike nuk ka pasur.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor ankesë kanë ushtruar:

-Prokuroria Themelore në Mitrovicë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe shkeljes së ligjit penal, duke propozuar që aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.43/2023, të dt.27.12.2023, të anulohet dhe çështja penale ti kthehet gjykatës së shkallës së parë, sa i përket pjesës liruese të aktgjykimit, dhe

-mbrojtësi i të akuzuarit F.R., av.Shyqri Syla, për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke propozuar që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet përkitazi me vendimin për dënimin për pikën I, pjesën gjyqësore dhe të akuzuarit ti shqiptohet vërejtja gjyqësore në kuptim të nenit 81 dhe 82 par.3 dhe 4 të KPK, me të cilin do të arrihet efekti dhe qëllimi i ndëshkimit.

Po ashtu përgjigje në ankesë të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, ka ushtruar mbrojtësi i të akuzuarit F.R., av.Shyqri Syla, duke propozuar që të refuzohet ankesa e prokurorisë, përkitazi me pjesën liruese, kurse të akuzuarit ti shqiptohet për pjesën dënuese një dënim më i butë.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë, me shkresën PPA/I.nr.154/2024, të datës 12.03.2024, duke u sqaruar përkitazi me ankesat e ushtruara, nga ana e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, ka propozuar që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të anulohet dhe lënda ti kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim e vendosje, përkitazi me pjesën liruese të aktgjykimit.

Sa i përket ankesës së mbrojtësit së të akuzuarit F.R., av.Shyqri Sylja, si dhe përgjigjes në ankesë të prokurorisë, ka propozuar që të njëjtat të refuzohen si të pabazuara.

Në kuptim të nenit 390 të KPPK, kolegji i kësaj gjykate ka caktuar seancën e kolegjit për dt.12.04.2024, dhe në mënyrë të rregullt i ka njoftuar të gjitha palët nga shkresat e lëndës.

Në seancë të kolegjit ka prezantuar mbrojtësi i të akuzuarit F.R., për këtë seancë të kolegjit me autorizim zëvendësues, av.Adem Vokshi, i cili e ka zëvendësuar av.Shyqri Sylja, si dhe i akuzuari F.R..

Nuk ka prezantuar Prokurori i Apelit, për kundër asaj që është njoftuar me rregull, e cila vërtetohet nga shkresat e lëndës.

Mbrojtësi i të akuzuarit F.R., av.Adem Vokshi, ka propozuar që ankesa e prokurorisë, të refuzohet si e pabazuar, kurse ankesa e mbrojtësit së të akuzuarit, të aprovohet si e bazuar dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënim me gjobë.

I akuzuari F.R., ka deklaruar se e mbështet në tërësi, fjalën e mbrojtësit.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenin 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesat e ushtruara, nga ana e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, si dhe mbrojtësit së të akuzuarit F.R., av.Shyqri Sylja, aktgjykimit të ankimuar, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

Ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, refuzohet si e pabazuar, kurse ankesa e mbrojtësit së të akuzuarit F.R., av.Shyqri Sylja, është e bazuar

Sa i përket kësaj çështje penale aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është ankimuar sipas ankesës së prokurorisë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, për pjesën liruese të aktgjykimit, duke pretenduar se në këtë çështje penale janë bërë shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, kur gjykata e shkallës së parë ka nxjerrë aktgjykim lirues, për pikën II të dispozitivit të aktgjykimit. Në këtë çështje penale janë dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me ekzistimin e veprës penale, përkatësisht përdorimit të aparatit GPS, nga ana e gjeodetit të Komunës së Mitrovicës, andaj përkundër asaj që janë vërtetuar elementet inkriminuese të ekzistimit të kësaj vepre penale, gjykata e shkallës së parë, ka nxjerrë aktgjykim lirues, pa dhënë ndonjë arsye më të posaçme, se pse i akuzuari është liruar nga akuza.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas ankesës së prokurorisë, përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 të KPPK, për të cilat shkelje përkujdeset edhe sipas detyrës zyrtare, në kuptim të nenit 394 të KPPK, dhe ka ardhur në përfundim se dispozitivi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, sikurse në pikën I, po ashtu në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, është i qartë, i kuptueshëm për secilën pikë, duke qenë në harmoni me vetveten si dhe duke mos pasur kundërshtim me arsyet e dhëna në aktgjykim.

Kolegji i kësaj gjykate ka ardhur në përfundim se në këtë çështje penale janë vërtetuar të gjitha faktet vendimtare sikurse në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit, lidhur me pjesën dënuese

të të njëjtit, e po ashtu dhe me pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, lidhur me pjesën liruese, ngase gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të qartë dhe të plotë, ka zbatuar dispozitat ligjore nga neni 384 i KPPK, e posaçërisht ka pasur parasysh dispozitën, nga neni 384 par.2 pika 2.7 lidhur me nenin 369 të KPPK, duke dhënë arsye të qarta dhe të plota, për çdo pikë të aktgjykimit, sikurse në pjesën gjyquese po ashtu në pjesën liruese.

Sa i përket pjesës gjyquese, aktgjykimi i nxjerrë është i mbështetur në dispozitën ligjore nga neni 364 të KPPK, ngase gjykata me aktgjykimin në pikën I, për të cilën e ka shpallur fajtor të akuzuarin, ka vërtetuar ekzistimin e veprës penale, duke vlerësuar të gjitha faktet dhe rrethanat që përbëjnë figurën e veprës penale, të cilët kushtëzojnë edhe zbatimin e dispozitës përkatëse ligjore, ashtu që ka vërtetuar elementet inkriminuese të ekzistimit të veprës penale, përdorimi i pa autorizuar i pasurisë nga neni 420 lidhur me nenin 77 të KPK. Gjithashtu, kolegji ka vlerësuar dhe pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, përkitazi me pjesën liruese dhe ka ardhur në përfundim se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të qartë ka zbatuar dispozitën ligjore nga neni 363 par.1 pika 1.3 të KPPK, duke nxjerrë aktgjykim lirues, sepse nuk ka vërtetuar se me veprimet e të akuzuarit janë kryer elementet e veprës penale për të cilën është akuzuar, ngase nuk ka mundur që të vërtetojë ekzistimin e së njëjtës, as me provat personale, e as me provat materiale.

Po ashtu duke u mbështetur në dispozitën ligjore nga neni 369 i KPPK, kolegji ka ardhur në përfundim se aktgjykimi e përmbushë formën e aktgjykimit me shkrim, duke i pasur të gjitha pjesët kryesore që duhet ti ketë një aktgjykim, duke dhënë elementet karakteristike në hyrje të aktgjykimit në dispozitiv të aktgjykimit, lidhur me përshkrimin e veprës penale, sikurse në pikën I dhe II, të dispozitivit të aktgjykimit, e po ashtu duke dhënë edhe arsye të mjaftueshme se pse në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit, është shpallur fajtor, dhe i është shqiptuar dënimi përkatës ligjor, kurse në pikën II, është liruar nga akuza, në mungesë të provave, përkatësisht pasi që nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Nga të gjitha këto vlerësime të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, kolegji ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Gjithashtu aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është ankimuar për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, kryesisht për pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, përkatësisht pjesën liruese, duke theksuar se në këtë çështje penale, nuk është kontestues që ditën kritike është përdorur GPS-aparati i Agjensionit Kadastral, për kryerjen e matjeve, në të cilin kanë mbetur gjurmë, se i njëjti është përdorur. Po ashtu kjo është vërtetuar edhe nga dëgjimi i dëshmitarëve, N.M., i cili e ka pohuar këtë fakt, sikurse edhe dëshmitari B.S., dhe H.M., të cilët kanë deklaruar se me datën sikurse përshkruhet, rezulton se GPS, është përdorur, mirëpo nuk dihet se kush e ka përdorë ngase ekzistojnë tre gjeodet të kualifikuar që mund të përdorin pajisjen e GPS, kurse nuk ka pasur ndonjë kërkesë zyrtare për përdorimin e të njëjtës. Përndryshe, informacioni i cili ka ardhur për përdorimin e të njëjtit, ka qenë anonim, dhe nga i njëjti nuk mund të dihet se nga ana e kujt është përdorur dhe për çfarë destinacioni është përdorur. Është evidente që në këtë çështje penale është zhvilluar procedurë disiplinore ndaj të akuzuarit F.R., dhe i është shqiptuar masa disiplinore, e kjo rezulton nga shkresat e dt.18.11.2021, mirëpo duke mos dhënë ndonjë detaj më të rëndësishëm për të vërtetuar ekzistimin e veprës penale për të cilën i njëjti ngarkohet. Që të gjitha provat nga shkresat e lëndës për këtë pikë të aktgjykimit, nuk janë vërtetuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, dhe e njëjta ka nxjerrë aktgjykim lirues në kuptim të nenit 363 par.1 pika 1.3 të KPPK, për të cilin mendojmë se i njëjti si i tillë është i pa qëndrueshëm dhe çështja penale për këtë pikë të aktgjykimit duhet ti kthehet gjykatës së shkallës së parë, në rigjykim e vendosje.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas ankesës së prokurorisë, përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe ka ardhur në përfundim se në këtë çështje penale, sa si përket pikës I të dispozitivit të aktgjyimit, i akuzuari F.R., e ka pranuar fajësinë për këtë veprë penale, duke pohuar se me dt.20.03.2021, në cilësinë e personit zyrtar, i punësuar në pozitën gjeodet, në Komunën e Mitrovicës së Jugut, duke shfrytëzuar pozitën, pa autorizim ka përdorë pasurinë e luajtshme të komunës dhe e ka shfrytëzuar dhe përdorë pajisjes GPS, pronë e komunës, dhe me të njëjtin ka kryer matjen gjeodezike të personave fizik, në territorin e Komunës së Vushtrrisë, duke vazhduar që të kryej të njëjtën punë edhe me dt.21.03.2021, ashtu që janë plotësuar elementet inkriminuese të veprës penale përdormi i pa autorizuar i pasurisë, nga neni 420 lidhur me nenin 77 të KPK, që nënkupton se kjo veprë penale është kryer në vazhdimësi.

Sa i përket kësaj veprë penale i akuzuari ka pranuar fajësinë për kryerjen e së njëjtës, që në shqyrtimin fillestar, mirëpo, nuk është pranuar pranimi i fajësisë nga ana e gjykatës, ngase për pikën III dhe IV, të dispozitivit të aktakuzës, nuk e ka pranuar fajësinë, ashtu që gjykata e shkallës së parë, ka vazhduar me shqyrtim gjyqësor, sikurse që kërkojnë dispozitat përkatëse ligjore.

I akuzuari ka pranuar fajësinë lidhur me veprën penale të aktgjyimit në pikën I, përdorimi i pa autorizuar i pasurisë, nga neni 420 lidhur me nenin 77 të KPK, dhe ka vazhduar me procedim të mëtejshëm, duke i proceduar provat materiale trupi gjykues, ashtu që ka dëgjuar edhe provat personale, sikurse janë deklaratat e dëshmitarëve, N.M., i cili ka qenë shef i sektorit për gjeodezi, i cili ka deklaruar se në këtë çështje penale para se të qitet në punë GPS, duhet të merret leja, kurse pas orarit të punës për çdo lëvizje, prapë duhet të merret leja, sepse aparati GPS, bënë incizime, kurse në komunë në atë kohë ka pasur gjashtë gjeodet dhe vetëm tre prej tyre, kanë pasur aftësi që ta përdorin ashtu që të njëjtën deklaratë të dhënë nga ana e të akuzuarit F.R., e kanë pohuar edhe dëshmitarët, B.S. dhe H.M., ashtu që sa i përket pikën III dhe IV të dispozitivit të aktakuzës, përkatësisht pikës II të aktgjyimit, nuk është mundur që të vërtetohet as me prova materiale, e as me prova personale, se ditën kritike, përkatësisht ditët kritike me dt.14 dhe 17.04.2021, të vërtetohet se i akuzuari e ka përdorur aparatën GPS, andaj në këtë çështje penale pasi që ka pasur prova të cilat nuk kanë paraqitur konsistencë për vërtetimin e gjendjes faktike, përkatësisht ka pasur dyshime, atëherë të njëjtat janë interpretuar në favor të të akuzuarit, duke u respektuar parimin “indubio pro reo”, dhe i akuzuari është liruar nga akuza.

Kurse, sa i përket pikës I të dispozitivit të aktgjyimit, pasi që i akuzuari ka pranuar fajësinë për këtë veprë penale, e njëjta është justifikuar edhe me prova të tjera, e sidomos pas dëgjimit të dëshmitarëve.

Sipas ankesës së prokurorisë, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është ankimuar edhe për shkak të shkeljes së ligjit penal, duke pretenduar se në këtë çështje penale gjykata e shkallës së parë, kur ka nxjerrë aktgjykim lirues për të akuzuarin F.R., e ka shkelur ligjin penal në favor të tij, duke liruar nga akuza, pasi që nuk ka gjetur prova që e vërtetojnë se i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, së bashku me shkresat e tjera të lëndës, sipas ankesës së prokurorisë përkitazi me shkeljet e ligjit penal dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk përfshihet me shkeljet e parapara në nenin 385 të KPK, as në pikën I, e as në pikën II të dispozitivit të aktgjyimit.

Kolegji po ashtu ka vlerësuar se në këtë çështje penale sa i përket pikës II të dispozitivit të aktgjykimit, ka gjetur rrethana të cilat e përjashtojnë të akuzuarin, nga ndjekja penale, si dhe nga përgjegjësia penale, të cilat janë vërtetuar nga provat në shkresat e lëndës të cilat, edhe janë vlerësuar gjatë shqyrtimit gjyqësor. Po ashtu kolegji vlerëson se në këtë çështje penale vepra penale për të cilën i akuzuari është akuzuar, është e paraparë në ligjin e aplikueshëm, se gjykata e shkallës së parë, ka vepruar në kuadër të kompetencës ligjore, kur ka vendosur për çështjen penale.

Sipas ankesës së mbrojtësit së të akuzuarit F.R., aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është ankimuar për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke pretenduar që në këtë çështje penale gjykata e shkallës së parë, ka pasur rrethana të bollshme lehtësuese që të akuzuarit ti shqipton një dënim sa më të butë, sikurse është edhe vërejtja gjyqësor, ngase i akuzuari ka shpreh gatishmëri që të pranon fajësinë që në shqyrtimin fillestar, se i njëjti ka kërkuar falje për veprën e kryer penale, është i martuar, baba i tre fëmijëve, se është mbajtës i vetëm i familjes, se ka pasur sjellje korrekte gjatë gjithë kohës së mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, se komunës nuk i ka shkaktuar kurrfarë dëmi me përonimin e aparatit GPS, andaj jemi të mendimit se rrethana rënduese në këtë çështje penale nuk ka pasur të asaj natyre, që të akuzuarit ti shqiptohet një dënim kaq i ashpër, ashtu që i propozon kolegjit të Gjykatës së Apelit, që ta ndryshon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të akuzuarit ti shqipton një vërejtje gjyqësore me të cilën do të arrihet efekti dhe shqiptimi i dënimit, apo ti shqipton dënim me gjobë.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas ankesës së ushtruar nga ana e mbrojtësit së të akuzuarit F.R., av. Shyqri Sylja, lidhur me vendimin për sanksionin penal të shqiptuar, aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, si dhe shkresat e tjera të lëndës, ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkeljet e ligjit penal, se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, e cila vërtetohet nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit për pikën I të dispozitivit të aktgjykimit, përkundër asaj që nga ana e gjykatës së shkallës së parë nuk është pranuar pranimi i fajësisë, kurse sa i përket pikës II të dispozitivit të aktgjykimit, përkritazi me pjesën liruese, i njëjti është vërtetuar nga të gjitha shkresat e lëndës.

Gjykata e shkallës së parë, ka vlerësuar të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në marrjen e vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, të parapara në nenin 69, 70 të KPK, ashtu që si rrethana lehtësuese ka pasur parasysh se i akuzuari e ka pranuar fajësinë lidhur me veprën penale e cila i vihet në barrë, përkatësisht në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit, se ka shprehur keqardhje për veprën e kryer penale si dhe ka premtuar që në të ardhmen nuk ka me ra në kundërshtim me ligjin, se ka kërkuar falje për veprën e kryer penale, se është i martuar, baba i tre fëmijëve, se asnjëherë tjetër nuk ka ra në kundërshtim me ligjin, e duke pasur parasysh mënyrën e kryerjes së veprës penale, si dhe shkallën e intensitetit të kryerjes së të njëjtës, aplikon dispozitën ligjore, nga neni 71 lidhur me nenin 72 të KPK, lidhur me zbutjen e dënimeve, si dhe kufijtë e zbutjes së dënimeve, dhe në rastin konkret duke vlerësuar ankesën e mbrojtësit së të akuzuarit, e sidomos rrethanat se i akuzuari ka pranuar fajësinë lidhur me veprën e kryer penale, se ka shprehur keqardhje për këtë veprë të kryer, dhe të akuzuarit i ka shqiptuar dënim më të butë, në raport me të shqiptuarin nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Të gjitha këto veprime janë ndërmarrë duke vlerësuar ankesën e mbrojtësit së të akuzuarit, është aplikuar Instituti i Zbutjes së jashtëzakonshme të dënimit, duke iu referuar rrethanave lehtësuese të lartë theksuara, dhe duke qenë i bindur se me dënimin e shqiptuar, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij, që të parandalojë kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin

shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, të paraparë në nenin 38 të KPK-së.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 403 lidhur me 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.158/2024, të datës 12.04.2024

Bashkëpunëtorja profesionale,
Ardianë Morina

Anëtarët e kolegjit,
Hashim Çollaku

Kryetari i kolegjit,
Xhevdet Abazi

Kadrije Goga Lubishtani